

VENDIM
Nr. 32, datë 13.12.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, neni 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 32, datë 13.12.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 7406, në ngarkim të N. B., me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1954–1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
2. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 4744, në ngarkim të H. S., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
3. Fondi 2 Oficer, Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje nr. 26, Buletin mbi të dhënat e rrjetit sekret informativ e burime të tjera në repartin e kufirit 310, me 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
4. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 6618, në ngarkim të H. L., me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
5. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 9060, në ngarkim të Xh. M., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
6. Fondi 2 Oficer, dosje nr. 9170, në ngarkim të A. M., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula